

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
PER AKTIVITETIN**

Asgjesim dhe riciklim i vajrave te perdorur



Subjekti :ANSOIL sha

Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit: Lagjja 17, Rruga Viktimat e 7 Shkurtit, Korçë

Korçë2021

HYRJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, shkarkimet ne toke, uje, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastruktures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjithë zonen, duke kryer vrojtime te ndryshme , si dhe te biodiversitetit.

Ne raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zones, hidrogjeologjia.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon . Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, çdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedisi eshte me gjithperfshires, cdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre . Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve
- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithe. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytetet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Qellimi i VNM- se

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te **aktivitetit Asgjesim dhe Riciklim i vajrave te perdorura.**

VNM nuk do te mbuloj cdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

-Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.

-Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.

-Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedisin human.

-Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.

-Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.

-Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

Objektivat e VNM

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit deri ne perfundim te tij dhe rehabilitimin e hapesires perreth objektit.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.

- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Perdorimin e burimeve natyrore ne menyren te qendrueshme ku respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones per rreth.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale negative te projektit te zbatuar
- Lehteson informimin e organeve vendim-marrese, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shendetit te njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peziashet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permireson aspektet sociale te projektit.

Pershkrim i metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te VNM

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis hartohet me kerkese te shoqerise **per aktivitetin Asgjesim dhe Riciklim i vajrave te perdorur.**

Studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua nga rendesia dhe madhesia e projektit, vendi ku ai do te zhvillohet , pasurite natyrore dhe humane te zones si dhe vlerat e vecanta te tyre ne identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutese duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes se projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme pozitive sidomos ne perfitime direkte dhe indirekte mbi komunitetin.

Studimi strukturohet ne kater faza kryesore :

- 1.Ngritja e objektivave orientuese te V.N.M.
- 2.Mbledhja e materialit baze ekzistues dhe atij te formuluar enkas per kete projekt dhe seleksionimi i tyre per perdorim.
- 3.Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te mundeshme biofizike dhe humane.
- 4.Hartimi i projektit bazuar ne legjislacionin Shqiptar si dhe kerkesave te organeve vendim-marrese dhe kontrollues te objekteve mjedisore ne nivel kombetar dhe lokal.

PERSHKRIM I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Subjekti ANSOIL sha është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më date 21/07/2010, me numër NIPT L04321001D dhe administrator Z.Julian Suljoti me objekt aktiviteti “Riciklim i vajrave te djegura” etj.


Subjekti është i pajisur me Leje Mjedisore Tipi C me date 07.01.2014 , nr.94 Prot, Vendimi nr.363 i komisionit të lejeve për aktivitetin “Perpunim ose perzierje vajrash lubfirikante, ambalazhim dhe tregtim I tyre”, me vendodhje Libonik, Korçë.

Subjekti eshte pajisur me shkrese nga AKM me nr.4378/1 prot date 28.09.2021 per perjashtimin nga procedura e VNM-se duke qen se eshte aktivitet ekzistues I pajisur me leje mjedisi Tipi C.

Vendodhja ku ushtrohet aktiviteti

Aktiviteti do te zhvillohet ne Libonik, Korce, ZK 2445.

	E	N
1	4475528.04	4507792.49
2	4475539.08	4507852.56
3	4475552.49	4507849.33
4	4475541.46	4507790.93



Vajrat e përdorura janë të gjitha vajrat minerale, lubrifikantë sintetikë apo industrialë që janë bërë të papërshtatshëm për përdorimin, për të cilin ishin prodhuar fillimisht. Vajrat e përdorura përfshijnë vajra të motorëve me djegie të brendëshme dhe vajrat e kutisë së ndërrimit të marsheve, vajrat lubrifikuese, vajrat për turbinat, vajrat për transformatorë dhe vajrat hidraulike.

Rigjenerim i vajrave të përdorura është çdo operacion riciklimi, me anë të të cilit vajrat bazë mund të prodhohen nga rafinimi i vajrave të përdorura, në mënyrë të veçantë duke hequr ndotësit, produktet oksiduese dhe shtuesit e tjerë, që gjenden në këto vajra.

Vajrat e mbetura

Direktiva mbi vajrat e mbetura 75/439/KEE, ndryshuar herën e fundit nga amendamenti i direktives mbi vajrat e mbetura 2000/76/KE është projektuar për të krijuar një sistem në harmoni për mbledhjen, ruajtjen, rikuperimin dhe asgjësimin /depozitimin e mbetjeve vajore, siç janë vajrat lubrifikante për automjete, turbina, motore dhe vajrat hidraulike. Direktiva ka gjithashtu si qëllim mbrojtjen e mjedisit kundër efekteve të dëmshme që vijnë si pasojë e hedhjeve ilegale dhe të përpunimeve. Është shumë e rëndësishme që vajrat e përdorur të grumbullohen sa më shumë në mënyrë që mos të kemi ndotje të mjedisit dhe po ashtu të kemi përfitim sa më të madh nga kjo rrymë mbetjesh.

Ky impiant perben nje investim dinjitoz e specifik ne fushen etrajtimit te vajrave te perdorur si dhe te mbetjeve te hidrokarbureve. Teknologjia e afruar eshtenje hap perpara ne procesin e trajtimit te mbetjeve te ricikueshme pa shkatuar ndotjen e mjedisit dhe njeherazi duke prodhuar produkte qe kerkohen nga tregu.

Shoqeria ka instaluar impiant per distilimin dhe riciklimin duke përfshirë vajin e motorit, vajin hidraulik, vajin e ingranazheve, vajin e ndotur të naftës, vajrat e përzier etj.

Impianti ngroh vajin e perdorur në (nga 110 °C në 350 temperature) temperaturë të ndryshme në kushte të larta vakumi, duke i bërë molekulat e hidrokarbureve të prishen. Shkalla e rikuperimit të vajit bazë të impiantit është më shumë se 85%.

Trajtimi i vajit te grumbulluar

Vaji i grumbulluar, do mblidhet nga pikat e servisit te automjeteve, Hec-et dhe Tec-et, ofiçinat metalprerese, ndermarje industriale, hekurudha etj. Per vete kushtet e shfrytezimit, vajrat e grumbulluar, klasifikohen ne dy kategori:

-Vajra te djegur ose vajra te nxjerra nga motoret e automjeteve

-Vajra te perdorur industriale si vajra hidraulike, vajra turbine, transformatori, vajra pompash e kompresori, dhe per rrjedhoje dhe trajtimi i tyre do behet me vete.

Impianti i rafinimit te vajit dhe mbetjeve të hidrokarbureve

Sherben per trajtimin e nje sere mbetjesh te vajrave lubrifikuese per te perfituar vaj baze te nje cilesie te larte dhe nje sasi te vogel nafte nepermjet distilimit ne vakum, si dhe për përpunimin e hidrokarbureve të ndryshme, naftë etj. Pas paratrajtimit mbetjet e vajit apo dhe hidrokarburet e tjera pompohen ne enen e distilimit dhe ngrohen deri ne temperaturen 350 grade. Nga procesi mund te nxirren vaj baze, nafte ose solar. Impianti përbëhet nga njësia e paratrajtimit të mbetjeve të vajrave apo hidrokarbure, nga njësia e përzjerjes së shtesave kimike kjo në vartësi të lëndës së parë që do trajtohet, nga njësia e distilimit (distilator periodic cilindrik me nje kolonë më disa pjata distilimi si dhe i pajisur me dy përzjerës me helikë), njësit e ftohjes së avujve të formuar gjatë distilimit, njësit e krijimit të vakumit që jane pompat e vakumit, pompat e ujit dhe depozitat e pritjes së produkteve sipas radhes së daljes së tyre nga komponentët me pikë vëlimi të ulët te ata me pikë vëlimi të lartë. Përgjithësisht nëse mbetja e hidrokarbureve përmban sasi të caktuara benzine, diezeli (naftë) dhe mbetje të rënda radha dhe temperatura e procesit të distilimit të tyre në vakum është si më poshte:

Duke qënë se përbërja e saktë nuk dihet ne bëjmë një distilim të tillë që e kategorizojmë në disa grupe të mëdha që janë: produktet e benzinës me një temperaturë të avujve nga 50 -110 °C, produktet e dieselit me temperaturë të avujve nga 110-220 °C, produktet e vajit bazë me temperaturë të avujve nga 220-300 °C, produktet vaji bazë i rënd me temperaturë të avujve nga 300-360 °C, ndërsa mbi 360 °C kemi hidrokarburet e rënda (ku futen dhe produktet bituminoze) deri në koksifikim të mbetjes. Duhet ritheksuar që procesi zhvillohet në vakum të plotë dhe temperaturat e sipërpërmendura nuk janë rigorozë por që janë një tregues shumë i mirë i zhvillimit të procesit. Intervale të mesiperme të temperaturave janë të rëndësishme pasi për secilin produkt impianti mbahet në ato temperatura në një kohë të pacaktuar e cila varet nga sasia e secilit nenprodukt që ndodhet në lëndën e parë për distilim. Gjatë procesit të rafinimit duke qënë se operohet në vakum një pjesë e gazeve që cirohen gjatë distilimit dhe që kanë temperaturë shumë të ulët të kondensimit nuk kondensojnë dhe të merren bashkë me produktet e tjera të kondensueshme në temperaturën e ftohësit të avujve. Rrjedhimisht këto gaze dallohen nga linja e distilimit dhe përzihen me ujin ftohës së kompresorit të krijimit të vakumit pasi këtë lloj strukture ka ky i fundit. Për këtë qëllim në i mbledhim këto në një deposite 3000 litër ku pjesa e gazeve që janë dhe të patretshëm në uji dalin dhe shkarkohen në atmosferë nëpërmjet një oxhaku me lartësi 10 m. Ndrërsa uji i kontaminuar me një sasi të vogël të hidrokarbureve të lehta i nënshtrohet trajtimit në impiantin e ujit të cilin e cojmë me anë të në pompe me një prurje prej 1.5 m³/h.

Pajisjet/makinerite në procesin teknologjik

Për të realizuar një proces teknologjik sigurisht që janë të nevojshme dhe pajisjet që përdoren për atë qëllim.

Në procesin e trajtimit në impiantine rafinimit të vajrave dhe hidrokarbureve pajisjet që përdoren janë:

- Pompat për marrjen dhe qarkullimin e lëndës së parë apo produkteve dhe gjysëmprodukteve me prurje që varjon nga 4 deri në 12 m³/h.
- Depozitat e lëndës së parë dhe produkteve me kapacitet nga 30 deri në 300 m³.
- Kaldaje avulli me presion deri në 12 bar dhe temperaturë deri në 190 °C
- Tanku i përzjerjeve të shtesave kimike
- Tanku i paratrajtimit me dy përziersa dhe me një kapacitet prej 14 m³
- Tanku i distilimit me dy përziersa dhe me një kapacitet 20 m³
- Njësit e kondensimit të avujve me rryma të kundërta në formë cilindrike
- Pompat për qarkullimin e ujit ftohës me prurje deri në 3 m³/h
- Depozitat e pritjes fillestare të produkteve me kapacitet deri në 2 m³

- Filtrat për filtrimin e produktit
- Brucator nafte për nxehjen e distilatorit për zhvillimin e procesit të distilimit
- Kompresorët për krijimin e vakumit në sistemin e distilimit (rafinimit)
- Depozita e pritjes së sasive të vogla të komponentëve të gaztë që si dhe ujit ftohës të kompresoëve
- Flowmeter për matjen e sasisë së produktit që prodhohet
- Sigurisht dhe matësat e presionit si dhe sensorët e temperatures

Ndërsa njësitë (pajisjet) që përdoren në impiantin e trajtimit të ujrave janë si më poshtë:

- Pompa për marrjen e ujit të ndotur me prurje që varion nga 3.5 deri në 20 m³/h
- Depozita për dekantimin primar të ujit dhe sasive të vogëla të hidrokarbureve që ka me kapacitet deri në 100 m³
- Vaskat për kalimin e ujit gjatë përpunimit në impiant
- Depozitat e elementëve kimik që përdoren për trajtimin e ujit
 - Depozit cilindrike me fund konik e llumrave për presim
 - Filtra për filtrimin e ujit
 - Pompat e qarkullimit të ujit në impiant si dhe pompat e tretesirave kimike
 - Filtërpres për presimin e fazes së rënd (llumrat)
 - Përzjersat në vaskat e qarkullimit të ujit
 - Sensorët për matjen e pH online në vaskën e hedhjes së acidit dhe atë fundore të hedhjes së bazes

Rradha e punes ne impiantin e vajit:

-Furnizohet depozita e paratrajtimi me vajte perdorur max 10 ton

-Ne kazanin e kimikateve hidhen kimikatet e meposhtme

KOH 2,4%

NaOH 2.4%

Uje 4.8%

Te gjitha keto perzihen me perzieres per afersisht 30 min per deri sa kimikatet e hedhura te treten plotesisht ne uje.

- Vihet ne pune p/vakumit nr.1 dhe hapet rruga per tek paratrajtimi. Me kete veprim lengu(uje +kimikate)kalon nga kazanin i kimikateve per tek paratrajtimi
- Mbyllet p/vakumit dhe vihet ne levizje perziersi tek paratrajtimi proces qe zgjat 3.5 ore
- Me ndihmen e pompes vaji tashme i perzier me kimikatet kalon ne distilator
- Ndizet brucatori ku fillimisht hapet dericka per shkarkimin e gazrave
- Takohen te tria p/ujit si edhe p/ujit mbi distilator
- Takohet p/vakumit nr.1 duke mbyllur rrugen e paratrajtimi dhe duke hapur ate te distilatorit
- Vihen ne pune perziersat e distilatorit
- Hapetrruganaftes (benzines) dhembylletajo e vajit
- Ne temp e brucatorit 170 C takohet p/vakumit Nr 2dhestakohetajo me Nr 1
- Ne temp 190 C takohetedhe p/vakumit Nr 3
- Ne temp 260 C takohetedhe p/vakumit Nr 4
- Duke pare tekxhami ne daljeteftohesitkomandojmesaracineskat per tek depot e vajitosekteknafta
- Vaji I grumbulluar ne depot perkatesekalohe me anetepompes ne kazanin e homogjenizimit kuperzihet per 5 min dhe me ane te pompes nepermjet te filtrit kalon ne depon e jashtme ku edhe behet magazinimi I tij
- Kur temp e brucatorit fillon e zbret deri 50 C nga max qe kishte arritur tregon se nuk kemi me vaj dhe duhet te fiket brucatori
- Mbas fikjes se brucatorit I leme p/ftohese ne pune edhe per 20 min dhe I fikim edhe ato
 - Ne temp 350 C (tek brucatori) stakohen p/vakumit Nr4 dhe 3
 - Ne temp 210 Cstakohet p/vakumit Nr 2
 - Ne temp 160 C stakohen te gjitha pompat
- Hapet saracineska e ajrit tek depo e vakumit dhe shkarkohet nga uji dhe mbetjet e karburantit
- Ne temp 150 C mund te shkarkohet distilatori nga mbetjet
- Ne temp 360 C duhet stakuar brucatori
- Kur temp e lengut ne dalje e kalon 110 C atehere duhet fikur brucatori dhe kur temp ne dalje te distilatorit zbret nen 360°C atehere brucatori rindizet

Ne rast se ngjyra e vajit fillon e nxihet (duke e pare ne xham) atehere brucatori duhet te kaloje ne pune me nje sprucator

- Furnizimi i ri i distilatorit te behet vetem kur kur temp tek brucatori te zbrese deri 150°C
- Ne rast te komandimit automatik te temp tek brucatori atehere duhet te rregjistrohet ne temperaturen 350-400°C.
- Nga nje cikel i procesit dalin keto nenprodukte (kur futim vetem vaj):

Vaji baze :65-68% (indeksi i njejte me SN150, SN 200)

Benzina :rreth 3% Nafta :rreth 3-4%

Mbetjet e vajit:26%-28%

Treguesit e vajit (njërit prej produkteve të rafinimit)

Nenproduktet qe perfitohen magazinohen ne rezervuaret perkates dhe tregtohen si lubrifikant ose si lende djeqese.

- **Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi**

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket vecorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone.

E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet vecorive te evolucionit paleogjeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore (gelqerore, magmatike, terrigjene) etj.

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitoklimatike te Shqiperise. Megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floristike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore (Graminaceae).

Bimet qe rriten ne zonen ku do te shfrytezohet nuk gezojne status te vecante te ruajtjes kombetare dhe nderkombetare te tyre.

- **Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer**

Shkarkime ne uje

Ujerat e shiut do te sistemohen permes kanaleve perimetrike dhe do I bashkohen kanalizimeve te zones. Te vetmet ujera qe gjenerohen jane ujerat sanitare nga aktiviteti I perditshem I punonjesve. Ne lidhje

me ujerat e perdorur ne aktiviteti eshte cdo gje me cikel te mbyllur. Ujrat e dala nga procesi distilimit te dekantuar ne rezervuar thithen me pompen dhe kalohen ne depoziten e ujrave te procesit. Uji I grumbulluar do te perdoret si component per prodhimin e bitumeve te emulsionuara.

Emetime ne ajer

Shkarkimet në ajër vinë nga dy burime kryesore të cilat janë: Kaldajat e avullit dhe impianti i rafinimit të vajrave dhe hidrokarbureve të tjera. Nga impianti i rafinimit kemi dy pika kryesore të cilat janë oxhaku për nxjerrjen e gazeve që vijnë nga djegia e lëndës djegëse për nxehjen e distilatorit si dhe gazet gjatë rafinimit që dalin kur operojmë në vakum nga kompresori i vakumit të impiantit.

Ndikimi ne toke

Mbetjet do të ruhen në depozita metalike. Ndotje të tokës mund të ketë vetëm në rastet aksidentale të rrjedhjeve të depozitave.

Ndikimi ne biodiversitet

Sipas verifikimeve të kryera lloji i aktivitetit nuk ndikon në biodiversitet. Flora dhe fauna e zonës nuk do të ndikohet nga aktiviteti i shoqërisë.

Zhurmat dhe vibrimet

Aktiviteti i punës është i tillë që nuk ka burime fikse të zhurmës. Gjithsesi si impakt zhurma mund të vije nga mjetet e transportit të mbetjeve. Subjekti duhet të kujdeset që transporti të kryhet në orare të caktuara (jo heret në mëngjes apo vonë në mbremje), si dhe makineritë e kompanisë transportuese të jenë në gjendje të mirë pune dhe i një viti të ri prodhimi.

Ndikime socio-ekonomike

Nuk parashikohen të shkaktohen ndikime negative nga zhvillimi i projekteve të tilla në pjesën sociale ekonomike, për arsye se këto projekte ndihmojnë në rritjen e punësimit.

- **Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve**

Uji do të përdoret për lagjen e territorit për paksimin e pluhurave gjatë procesit të levizjes së automjeteve dhe do të sigurohet përmes depozitave nga shoqëria. Ujra të ndotura nuk do të ketë, sepse uji nuk përdoret në procese teknologjike.

Ujrat e shiut do të sistemohen përmes kanaleve perimetrike dhe më pas do të bashkohen në kanalizimeve të zonës. Thëksojmë se këto ujrat nuk përmbajnë elemente kimike ndotëse.

Zhurmat kryesisht do të krijohen nga levizja e automjeteve. Burimet e zhurmave janë në sipërfaqe. Çdo burim përhap varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimit të të gjitha pengesave ekzistuese, ndërmjet burimit dhe receptorit.

Energjia zvogëlohet për gjatë rrugës si rezultat i absorbimit të sipërfaqeve, divergjencës gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Program i përdorur për llogaritjen e nivelit të zhurmave merr parasysh faktori

“A” – niveli i presionit të zhurmës të llogaritur

Faktori « A » përbehet nga kontribuesit që vijojnë

Niveli i fuqisë së zhurmës në drejtim të përhapjes $L_{ne \text{ drejtim të eres}}$, llogaritet për çdo burim

$$L_{ne \text{ drejtim të eres}} = L_{W_} - A$$

Niveli i zhurmave të këtyre automjeteve, është i atij niveli që nuk influencën si për të punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat për rreth të tij. Fenomene të tilla si vibracion zhvillimi i aktivitetit nuk do të ketë.

Mbetjet që krijohen do të jenë vetëm mbetje me karakter urban nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve. Këto mbetje do të grumbullohen në kosha plastike dhe me pas do të depozitohen në vendin e caktuar nga bashkia.

- **Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar**

Gjatë fazës normale të zhvillimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, floren dhe faunën e zonës, burimet ujore.

- **Te dhëna për shtrirjen e mundshme hapësimore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të**

Duke njohur aktivitetin që do të zhvillohet u identifikuan ndikimet e mundshme negative në çdo receptorë - përberës të mjedisit .

Identifikimi i ndikimeve – Përmes të cilit u përcaktua ndëryprimi mjedis-projekt , u identifikuan ndikimet e mundshme gjatë kësaj faze sipas receptorëve të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimeve – Ekspertët mjedisorë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për matjen e gravitetit të ndikimeve . Vlerësimi i Sinjifikancës ka të bëjë me vete rëndësinë e ndikimeve dhe është faza më e rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe përfaqëson atë me objektivisht me teresinë e bashkëveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e përdorur për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve variojnë dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit të ndikuar.

Shtrirja fizike- Vlerëson sipërfaqen apo dimensionin hapësior të një ndikimi të dhënë në raport me burimin që gjeneron atë ndikim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlerëson se sa do të zgjase një ndikim i caktuar në dimensionin kohë (ndikim i përhershëm apo i përkohshëm).

-**Kthyeshmëria** –Vlerëson mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e tij të mëparshme (aftësia për tu rehabilituar dhe regjeneruar)

-Rendesia – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime negative ne zone. Zhurmat qe krijohen nga levizja e mjeteve qe do te sjellin dhe transportojne mbetjet nuk perbejn ndotje akustike. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto mjete tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz , e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate furnizimit. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

Ne kushte normale te zhvillimit te aktivitetit nuk vleresohen ndikime te rendesishme te cilat mund te shkaktojne ndotje ne distance te medha.

- **Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin**

Qëllimi i planit të rehabilitimit

Përgatitja dhe zbatimi i këtij plani rehabilitimi përgatitur në zbatim të kushteve të lejes mjedisore të veprimtarisë për të rehabilituar objektin ku është vendosur instalimi sipas kërkesave ligjore mjedisore duke riaftësuar sipërfaqen e ambientit të shfrytëzuar, nëse shoqëria **“ANSOIL”** për arsye të ndryshme do të mbyllë aktivitetin e saj apo do të transferoje instalimin ne nje vendodhje tjeter.

Synimet e Planit të Rehabilitimit

Plani i rehabilitimit synon që

- Të ketë realizuar stabilizimin fizik të objektit ku ndodhet instalimi.
- Të ketë realizuar punimet biologjike me qëllim mbrojtjen e mjedisit të zonës dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.
- Te kete pastruar te gjithë siperfaqen ne shfrytezim nga instalimet dhe mbetjet e ndryshme, si dhe rikthimin e saj ne gjendjen e meparshme
- Të ketë mundësuar zhvillimin e proceseve natyrore të cilat dallohen qartë nëpërmjet indikatorëve abiotike dhe biologjike dhe evoluojnë me stadin e zhvillimit të riaftësimi

Hapja dhe mirëmbajtja e rrugës të brendshme automobilistike

Shoqëria **“ANSOIL”**, eshte kujdesur për mirëmbajtjen e infrastrukturës së brendshme rrugore, nën administrimin e saj dhe që i shërben qëllimit kryesor të kësaj shoqërie. Subjekti ka sistemuar te gjithë sheshin ne dispozicion duke shtruar nje siperfaqe me beton dhe pjesen tjeter me zhavorr.

Mirëmbajtja e kanaleve për drenazhim

Me qëllim mbrojtjen nga përmbytjet shoqëria realizon mirëmbajtjen dhe ben pastrim periodik të sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut në territorin ku ndodhet Instalimi.

Mirëmbajtja e bimësisë

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, shoqëria kujdeset për mbarëvajtjen e bimësisë së zonës.

Synimi i saj është shtimi i hapësirave të gjelbërta në territorin ku zhvillon aktivitetin e saj, rrethimi i objektit me kurorë pemësh autoktone duke harmonizuar objektin me vlerat biologjike të zones.

- Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Me qëllim që të parandalohen, shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore të aktivitetit gjatë zhvillimit të tij, investitori duhet të marrë masat e duhura për mbrojtjen e mjedisit. Këto masa përfshijnë masa të përgjithshme, si dhe për minimizimin e impakteve negative.

Lloji i ndikimit	Masa për zbutjen e ndikimit	Efektet e masës zbutëse
Emetimet në ajër, pluhura dhe gaze	<ul style="list-style-type: none">• Kontrolli periodik i makinerive për të siguruar emetim brenda normave të lejuara;• Planifikimi paraprak i punës dhe realizimi në kohë sa më të shkurtër.• Spërkatja me ujë (veçanërisht në kohë të thatë) të territorit ku zhvillohet aktiviteti	Uj përqëndrimin e grimcave të ngurta dhe gazeve në ajër.
Krijimi i zhurmave	<ul style="list-style-type: none">• Të mirëmbahen automjetet e punës;• Të ndalohet rënia e borive në zonat e banuara;• Në zonat e banuara të qarkullohet me shpejtësi të kufizuar;• Makinat e transportit dhe pajisjet të jenë bashkëkohore që plotësojnë standardet kombëtare, të pajisura me marmitë selenciatore të pakësimit të zhurmave.	Uj shkallën e bezdisjes që vjen nga prania e zhurmave.
Gjenerimi i	Mbetjet urbane vlerësohen të	Shmang përhapjen e

mbetjeve	jenë në sasi të vogël (pasi numri I punonjesve eshte I vogel) për menaxhimin e tyre kompania të zbatojë këto masa: Mbetjet të meren çdo ditë nga punonjësit apo një person përgjegjës për tu dërguar në kontenerët e përcaktuar nga pushteti vendor.	mbetjeve në mjedis, mbron mjedisin dhe shmang impaktin viziv të padëshiruar.
----------	---	--

Incidente	<ul style="list-style-type: none"> • Kompania investitore do të marrë masa për MNZ (mbrojtje nga zjarri). • Subjekti te vendose mbajttese sekondare per te shmangur ndonje incident te mundshem. 	<ul style="list-style-type: none"> • Parandalon incidente të mundshme në lidhje me zjarrin. • Minimizon ndikimin e perhapjes se mbetjes ne rast incidenti.
-----------	--	--

Masat që duhen konsideruar për të minimizuar ndikimin në mjedis janë:

a) Duhet të tregohet kujdes në respektimin rigoroz të kushteve teknike në objekt për të reduktuar mundësitë e rënies së zjarrit në objekt dhe avaritë në sistem duke shmangur shpërndarjen e produktit në mjedisin e zonës përreth. Djegia e lëndës së depozituar është tepër e dëmshme për mjedisin e zonës dhe banorët e zonës, të cilët kanë si një nga mënyrat kryesore të mbijetesës përdorimin e tokave bujqësore.

b) Mbetjet hidrokarbure, ose vajrat lubrifikante të përdorur, të seperuara të grumbullohen dhe të rifuten për përpunim në impiant.

c) Lidhur me mbetjet e grumbulluara për përpunim duhet që kompania të ketë një databasë të sasive që grumbullohen si dhe duhet të kontrakttojë subjekte për grumbullimin dhe ruajtjen e tyre.

d) Sasia depozituese të mos i kalojë volumet e parashikuara në mënyrë që situata të jetë e kontrollueshme.

e) Të zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri në mënyrë që të përballojë sasinë e depozituar të lëndës djegëse në raste të avarive të ndryshme.

f) Punonjësit të jenë të trajnuar paraprakisht dhe të jenë vazhdimisht në mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjatë proceseve të punës. Punimet e mirëmbajtjes të kryhen në përputhje me kushtet teknike të punës.

Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar

Zhvillimi i këtij projekti nuk ka ndikim në mjedisin ndërkufitar pasi zona ku do të ndërtohet është larg kufijve. Vendndodhja e projektit është në fshatin Libonik, QarkuKorce e cila është brenda kufiritShqiptar dhe ka një distancë të konsiderueshme nga shtetet fqinje.